




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.561/2023
Datë: 27 dhjetor 2023

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, si dhe nenit 2, paragrafi 2.1 nenit 3, paragrafi 3.5 dhe nenit 7 të Rregullores Nr.02/2019 për Rekrutimin, Emërimin, Trajnimin, Shpërblimin, Disiplinimin dhe Lirimin nga Detyra e Gjyqtarëve Porotë, në vazhdimin e takimit 318-të, të mbajtur më 27 dhjetor 2023, merr këtë:

V E N D I M

- I. Znj. Saime Sylaj, emërohet në pozitën e gjyqtarit porot, në Gjykatën Themelore në Pejë, me mandat 5 (pesë) vjeçar, me të drejtë ri-emërimi.
- II. Znj. Sylaj, do të filloj punën në Gjykatën Themelore në Pejë, nga data 1 janar 2024.
- III. Vendimi hyn në fuqi me datë 27 dhjetor 2023.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës, më datë 28 korrik Këshilli, ka shqyrtuar raportet e Komisioneve Vlerësuese për pozitat e gjyqtarëve porotë dhe të vendos për emërimin 76 kandidatëve për gjyqtarë porotë në gjykatat përkatëse, duke përfshirë edhe degët.

Me datë 14 dhjetor 2023, Gjykata Themelore në Pejë, pas zhvillimit të procedurave rekrutuese dhe përfundimit të trajnimit teorik dhe praktik, ka dërguar raportin plotësues për gjyqtarë porotë, që e njëjta të shtohet në listën e aprovuar më parë.

Këshilli, pas shqyrtimit të këtij raporti, vendosi të emëroj Znj. Saime Sylaj, gjyqtare porote, në Gjykatën Themelore në Pejë, si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ

Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës



Kopje e vendimit i dërgohet:

- Znj. Saime Sylaj;
- Kryetarit të Gjykatës Themelore në Pejë;
- Sekretariatit të KGJK-së,
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në SKGJK, si dhe Arkivit.